



VENDIM

Nr. 57 Datë 08.05.2012

PËR

**FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT TË APLIKIMIT
TË SHOQËRISË “LU & CO ECO ENERGY 2011” SH.P.K PËR
KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT PRODHUES “HEC OSTREN I
VOGËL” SI BURIM I RINOVUESHËM ENERGJIE**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2, gërma “l”, 9 dhe 39 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” të ndryshuar, nenit 18 pika 1 germa “d”, të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s të miratuara me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 21 datë 18.03.2009, te ndryshuar, dhe neneve 7 pikat 1 dhe 2 dhe 8 të Rregullave dhe Procedurave të Çertifikimit të Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e Rinovueshme të miratuara me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 9, datë 21.02.2007, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 08.05.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “LU & CO ECO ENERGY” sh.p.k për kualifikimin e impiantit prodhues HEC “Ostren i Vogël” si burim i rinovueshëm energjie,

Konstatoi se:

Aplikimi i paraqitur nga shoqëria “LU & CO ECO ENERGY” sh.p.k, është konform Rregullave dhe Procedurave të Çertifikimit të Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e Rinovueshme si më poshtë:

- **Neni 7, pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”**
Përshkrimi i përgjithshëm i centralit.

Ky dokumentacion është dhënë i sakte dhe i plote.

- **Neni 7, pika 2, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”**
Dokumentacioni vijues grafik, koreografia, planimetria e përgjithshme, skema funksionale etj.

Ky dokumentacion është paraqitur ne mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

VENDOSI :

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “LU & CO ECO ENERGY” sh.p.k, për kualifikimin e impiantit prodhues “HEC Ostren i Vogël” si burim i rinovueshëm energjie.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.